

Shtëpia e Librave shok
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE
01.01.2021– 31.12.2021

Shoqëria **Shtëpia e Librave shpk** i ka ndërtuar Pasqyrat Finaciare për vitin 2021 në bazë të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit dhe përkatësisht në mbështetje të plotë të SKK 15. **Shtëpia e Librave shpk** kryen shërbime shitje dhe shpërndarje të librave përmes faqes së saj online dhe fizikisht. Gjithashtu, **Shtëpia e Librave shpk** ka zhvilluar edhe procese të botimit të librave.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke ndjekur e zbatuar:

Politikat Kryesore Kontabël:

Politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e të drejtave, njohjen e të ardhurave e shpenzimeve dhe vlerësimin e tyre.

Parimet Kontabël:

Parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, Parimi i Njësisë Ekonomike Raportuese, Parimi i vijimësisë së veprimtarisë ekonomike si dhe Parimi i Kompensimit.

Karakteristikat cilësore të informacionit Kontabël:

Karakteristikat kryesore që janë mbajtur parasysh gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2021 janë: Kuptueshmëria, Rëndësia dhe Materialiteti, Besueshmëria, Parimi i Paraqitjes me Besnikëri, Parimi i Përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore, Paanshmëria, Parimi i maturisë, Parimi i plotësisë, qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë .

BILANCI KONTABËL

AKTIVI I BILANCIT

Shënimi 1:

Mjete monetare

Nr.	Emertimi bankës	Numri llogarisë	Shuma në monedhë e huaj	Kursi I kembimit datë 31.12.2021	Shuma ne lekë
1	Banka Kombëtare Tregtare				184'815.02
2	Intesa SanPaolo Bank				10'900
3	Intesa SanPaolo Bank USD		103.04	106.54	
3	Raiffeisen Bank				771'072.10
4	Raiffeisen Bank EUR		195.93	120.76	
5	Raiffeisen Bank USD		76.83	106.54	
6	Arka në lek				208'639
Shuma					1'218'250

Shënimi 2:

Llogari/Kërkesa të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme të subjektit në fund të vitit 2021 janë sa më poshtë:

1. Adrion shpk me vlerë 223'306 ALL.
2. Fatmir Xhaferri me vlerë 35'258 ALL.
3. Safe Security Albania me vlerë 35'750 ALL.

Në total vlera e klientëve është 294'314 ALL të cilët ende nuk janë arkëtuar nga subjekti ynë.

Shënimi 3:

Aktive Afatgjata materiale

Aktive Afatgjata materiale të subjekti janë amortizuar tërësisht në bazë të normave të amortizimit sipas ligjit të Procedurës Tatimore, por këto aktive janë ende në përdorim nga subjekti jonë. Aktivitet janë lap – topi dhe printeri i librarisë.

DETYRIMET DHE KAPITALI I VET

Shënimi 4:

Detyrime Tregtare

Vlera prej 77'009 lekë përbën detyrimin e kompanisë ndaj organeve tatimore dhe furnitorëve në lidhje me:

- Shumën e ***sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*** me vlerë 30'060 lekë të llogaritur dhe të mbajtur nga kompania për llogari të punonjësve të saj të cilat nuk janë paguar ende për periudhat Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2021 dhe të cilat do të paguhen në janar 2022;
- ***Të pagueshme ndaj furnitorëve*** me vlerë 30'569 lekë e cila nuk është shlyer ende dhe që janë kundrejt shtëpisë botuese Damo.
- ***Hua nga ortakut i vetëm*** me vlerë 1'855'500 lekë, e dhenë hua nga ortakut për kompaninë me interes 0 (zero);
- ***Detyrime tatimore për Tatimin në Burim*** në një vlerë prej 9000 lekë e cila përfaqëson tatimin mbi qeranë e muajit Dhjetor 2021 dhe e cila pritët të paguhet në janar 2022.

Shënimi 5:

Parapagimet e arkëtuara

Subjekti ka detyrimin për të përfunduar dërgimin e porosisë për klientin Heinrich Bol Stiftung Tirana në shumën 768'427 ALL.

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas Parimit të Kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogariten me besueshmëri.

Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve dhe në të njëjtin periudhë kontabël me të ardhurat e lidhura.

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve e ndërtuar sipas Natyrës.

Shënimi 6:

Të Ardhurat

Të ardhurave janë në vlerën e 6'175'298 lekë, që përfshinë të ardhura të realizuara nga shitja e librave dhe nga botimet e vetë shtëpisë botuese.

Shënimi 7:

Shpenzimet

Shpenzimet e kompanisë gjatë vitit financiar 2021 janë në vlerën 5'531'834 lekë. Vlerën më të lartë të shpenzimeve e zënë shpenzimet për produktet e shitura me vlerë 3'245'112 lekësh.

Rezultati i periudhës ushtrimore është pozitiv, duke rezultuar në fitim prej 643'464 lekësh.

Administrator

Gjergj Erebara